

## AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE

“Xhei Konstruksion” sh.p.k

Tiranë, më datë 29/04/2024

### NENI 1

Shoqëria Tregtare “Xhei Konstruksion” sh.p.k (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statutit të miratuar prej saj.

### NENI 2

- EMRI I SHOQËRISË Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “Xhei Konstruksion” sh.p.k

### NENI 3

- OBJEKTI I VEPRIMTARISË Shoqëria do të ketë si objekt ushtrimin e të gjitha veprimtarive të mëposhtme: Ne Fushen e ndertimit, Zhvillimit të pasurive të paluajtshme etj..

### NENI 4

- SELIA E SHOQËRISË Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Twin Towers, Tower B, kati 5, Prane BLC, Tiranë.

### NENI 5

- KAPITALI I SHOQËRISË Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën 100.000 Lek. Kapitali ndahet në 1 (njw) pjesë dhe pronësia e kuotave nga ortakët e shoqërisë vijon si më poshtë:

"1.Hatixhe Dyrmishi, lindur në Tiranë, më 01/05/1999, shtetas Shqiptar, mbajtëse e pasaportës me nr.BJ5401574, zotëron 100% të kuotave, e barabartë me një pjesë, me një vlerë të përgjithshme prej (100.000) lekë.

Kapitali themeltar është investuar nga ortakja themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga Ortakët Themelues.

### NENI 6

- KOHËZGJATJA E SHOQËRISË Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i veprimtarisë fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

### NENI 7

- ORGANET DREJTUESE Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon: 1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës; 2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë. Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cilët zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i parë i Shoqërisë Hatixhe Dyrmishi, lindur në Tiranë, më 01/05/1999, shtetas Shqiptar, mbajtëse e pasaportës me nr.BJ5401574, me nr ID J95501052H person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me një afat emërimi prej 5 (pesë) vitesh, afat ky fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

#### **NENI 8**

Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë ekspertin kontabël. NENI 9 Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### **NENI 10**

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

#### **NENI 11**

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### **NENI 12**

- ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

#### **NENI 13**

- DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE Akt i Themelimit hartohet në 5 (pesë) kopje në gjuhën shqipe

*Hatixhe Dyrmishi*

*[Signature]*